



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të dhëna me neni 10 paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 nën paragrafi (c), të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 04.08.2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Z. GRANIT SHALA** emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga subjekti politik "NISMA-Nisma për Kosovën" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z. Baton Dushi.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet z. Granit Shala dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 08.07.2020, Nr.668/2020, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal z. Baton Dushi pas dorëheqjes së tij përvokueshme nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Komunës, për arsye të angazhimeve tjera.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidati i radhës në listën e rirenditur i cili është, z. Granit Shala, ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit si kandidat i radhës, nga i njëjti subjekt politik, e gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2017, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 04.08.2020

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve


Valdete Daka
